

RAPORTIN TEKNIK TË PROJEKTIT




NDERTIM DHE FUNKSIONIM I FABRIKES PER PERPUNIMIN E QUMESHTIT


Qukës, Bashkia Prrenjas, Librazhd

Investitori: Engjellush ALLIU

Zhvilluesi: "BANI/S" Sh.p.k.

Tirane, Gusht 2016





Projekti i paraqitur, do te zhvillohet ne pronen e Z. Engjellush Alliu, Zona kadastrale 3120, Fshati Qukes Shkumbin, Njesia Administrative Qukes, Bashkia Prenjas, rrethi Librazhd.



Pozicioni i struktures ne zhvillim mbi releivin topografik

KORDINATAT NË SISTEMIN GAUS KRYGER		
NR.	X	Y
Pika 1	44 54 736.12	45 50 051.72
Pika 2	44 54 772.07	45 50 034.43
Pika 3	44 54 715.63	45 49 947.21
Pika 4	44 54 683.72	45 49 962.67

c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti

Zona Gjeografike: Përrenjasi kufizohet në veri me bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Elbasan. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Përrenjasit.


Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Përrenjasi ka një popullsi prej 24,906 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 33,031 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 322.95 km². Sipas censurit, densiteti i popullsisë është 77 banorë/km² ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 102.279 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Përrenjas, Qukës, Rrajcë dhe Stravaj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 25 fshatra.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Elbasan	Qyteti Përrenjas	Përrenjas	Qyteti Përrenjas, Fshatrat; Përrenjas-Fshat, Rrashtan	24,906	33,031	322.95
		Qukës	Fshatrat; Qukës Shkumbin, Qukës Skënderbej, Skroskë, Mënik, Gurrë, Bërzeshtë, Fanjë, Karkavec, Dritaj, Pishkash, Pishkash Veri			
		Rrajcë	Fshatrat; Rrajcë, Sutaj, Skënderbej, Bardhaj, Katjel, Kotodesh, Urakë			
		Stravaj	Fshatrat; Stravaj, Stranik, Farret, Shqiponjë, Sopot			

Profili i bashkisë

Bashkia e re e Përrenjasit përfshin sipërfaqe të shumta pyjore dhe burime të bollshme hidrike si dhe një fushë pjellore. Nëntoka është e pasur me krom, ndërkohë që ky mineral shfrytëzohet aktualisht në dy prej fshatrave të bashkisë së re.



Zonat e Rrajcës, Qukësit dhe Stravajt kanë sipërfaqen më të madhe të pyjeve në këtë zonë. Megjithatë, shfrytëzimi pa kriter gjatë dy dekadave të fundit i ka dëmтуar pyjet në një masë të gjerë.

Bashkia e re e Përrenjasit ka një pozicion të favorshëm gjeografik, pasi gjendet fare pranë dy pikave doganore me Maqedoninë. Por ky avantazh nuk është shfrytëzuar deri më sot për nxitjen e sipërmarrjes dhe shtimin e vendeve të punës.

Përgjatë tranzicionit, në këtë zonë kanë munguar strategjitë e zhvillimit. E megjithatë, emigracioni në zonën e Përrenjasit nuk ka qenë i lartë. Kjo pasi shumë



banorë të zonës kanë zgjedhur punësimin sezonal në Maqedoninë fqinje, me të ardhurat e të cilëve mbijeton një pjesë e mirë e popullatës.

Në të gjithë bashkinë e re rezultojnë të regjistruara 234 biznese, të cilat e kryejnë aktivitetin e tyre kryesisht në shërbime. Një pjesë e vogël e bizneseve merren me kultivimin e troftës.

Bashkia e Përrenjasit ka potenciale të pashfrytëzuara për turizëm natyror. Me historinë e pasur të zonës së Rrajcës, ku ndodhet shkëmbi i Skënderbeut dhe legjenda për Sofrën e tij si dhe me bukuritë natyrore të Sopotit, zona mund të kthehej në një destinacion për vizitorë vendas dhe të huaj.

Etnografia e pasur me këngët dhe vallet karakteristike të zonës do të ndihmonin për këtë qëllim, por mungesa e infrastrukturës rrugore i bën këto resurse të paarrtshme nga turistët.

Sfidat me të cilat do të përballtet pushteti vendor pas ndarjes së re

Papunësia mbetet plaga kryesore për banorët e Përrenjasit dhe një sfidë për kryebashkiakun që do të zgjidhet më 21 qershor. Investimet në fasoneri konsiderohen një mundësi e mirë për punësimin e grave të zonës, ndaj nxitja e bizneseve të kësaj fushe duhet të jetë një prioritet për mandatin 4-vjeçar.

Përmirësimi i godinave arsimore si dhe reabilitimi i infrastrukturës rrugore të fshatrave konsiderohet një tjetër sfidë e rëndësishme për zhvillimin e bashkisë së re. Nga ana tjetër, qyteti vuan nga mungesa e ujit të pijshëm, nga ndriçimi i zonave publike dhe nga shërbimi i pastrimit, çështje që kërkojnë gjithashtu një administrim më të mirë.

Por edhe pse Përrenjasi ka probleme të shumta me punët publike, shoqëria civile vlerëson se detyra kryesore e bashkisë së re është mbrojtja e pyjeve dhe mirëadministrimi i aseteve minerare, në mënyrë që këto resurse të kthehen në të ardhura për buxhetin e bashkisë dhe komunitetin.

Administrata vendore e bashkisë

Bazuar në të dhënat e publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në datën 21 qershor 2015 në bashkinë e Përrenjasit kishin të drejtën e votës 24,174 votues. Gjatë zgjedhjeve të fundit lokale, në datën 21 qershor 2015, në këtë bashki votuan gjithsej 13,786 votues, 57.03% e zgjedhësve.

Rezultatet e këtyre zgjedhjeve nxorrën fitues në garën për kryetar bashkie Znj. Miranda Rira të Aleancës për Shqipërinë Europiane, me 57.73% të votave.


d) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit

Kjo fabrike lidhet me qendren e banuar me ane të rruges që ndodhet në verilindje të sheshit të ndërtimit. Përreth sheshit të ndërtimit ka shumë pak objekte të tjera. Prona ka një sipërfaqe prej 4250 m² dhe ndodhet në fshatin Qukes në Librazhd. Ky truall me këtë sipërfaqe është parashikuar për fabrike të përpunimit të qumështit dhe



siperfaqe totale e kompleksit do te jete 770 m². Gjeresia e rruges ne veri-perendim te sheshit eshte 4.5m.

Sheshi i ndërtimit te objektit Fabrike e Perpunimit te Qumeshtit me investitor z. Engjellush Alliu ndodhet ne fshatin Qukes ne bashkine e Librazhdit. Parcela prej 4250 m² kufizohet ne pjesën veriore me pasurine 296, në atë lindore me pasurine 366/10 jugore me pasurine 366/8 dhe perëndimore me pasurine 370/2. Konfigurimi i parcelës i afrohet një forme te rregullt e orientuar sipas aneve te horizontit. Konfigurimi i objektit erdhi si rrjedhoje e një sere faktorësh: destinacioni i objektit si dhe funksioni i tij, konfigurimi i vete parcelës dhe orientimi saj. Përparësi i është dhënë pothuajse te gjitha faqeve te objektit pasi per vete nga funksioni i objektit te gjitha faqet jane trajtuar.



Intensiteti i ndërtimit nuk duhet të tejkalojë vlerën prej 1m³/m². Në rastin tonë intensiteti i ndërtimit është 0.72 m³/m².

Me poshte paraqiten treguesit e zhvillimit te prones:


– Siperfaqja e prones qe zhvillohet:	4250 m ²
– Siperfaqja e truallit e zene me strukture ndertim:	770 m ²
– Koef. Shfrytezimit te truallit per ndertim:	18.1%
– Lartesi maksimale e struktures:	4 m
– Numri i kateve mbi toke:	1 Kat
– Vellimi i struktures:	3080 m ³






NDARJA FUNKSIONALE

Hyrja per ne shesh është menduar nga ana veriore. Ne këtë pjese kemi hyrje per punonjesit, automjetet si dhe gjelbërim. Përsa i perket objektit ka hyrje vetem ne kete ane duke ju pershtatur vete funksionit, ne ate veriore nuk jane lene hapje ne fasade pervec hyrjes kryesore, ndersa ne ate perendimore dhe lindore jane krijuar hyrje dhe dalje per sherbimet si dhe dritare per nje ajrim natyral te objektit.



Kati perdhe



Kati perdhe, eshte projektuar ambjent sherbimesh plus ambient zyresh per administraten, natyrisht parësore ka qene zgjidhja funksionale, per te siguruar nje konfort sa me te larte per perpunimin e produkteve te qumeshtit.

-Struktura e godines

Përsa i përket anës konstruktive objekti është konceptuar me skelet b/a, dhe konstruksion mur tulle, gjë që jep dore ne modelimin e volumit dhe ne ndarjen funksionale. Mbulesa eshte me cati me profile metalike – kapriate, dhe panel sanduic.

-Rifinitura dhe elementet arkitektonike

Rifinitura ka shoqëruar volumin. Janë evidentuar elementet te thjeshte arkitektonike duke perdorur ngjyren gri. Nga ana estetike godina është mbajtur e pastër duke vepruar me keto elemente te thjeshte arkitektonike te cilët bëjnë qe godina te jete një e tërë dhe ne harmoni te plote me sheshin e ndertimit. Rifinitura është menduar kryesisht me suva.

Duke e pare ne tërësi objekti qëndron mire ne parcele, respekton kondicionet urbane dhe i plotëson kushtet per te qene një objekt i ri bashkëkohor.

Objekti eshte ideuar dhe projektuar qe te jete model dhe i llojit te vecante si godine e perpunimit te produkteve blektorale, me konstruksion beton arme te kombinuar me konstruksione te lehta te tipit sanduic etj, qe i japin vlera te vecanta, jo vetem nga ana funksionale, por edhe ajo arkitekturore me abjnetin perreth, me pamje shume te pelqyeshme e fine.


- e) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasi të e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit

Objekti zhvillohet me një kat, me Struktura Beton/Arme monolite dhe mbulimi me konstruksion metalik dhe veshje paneli sanduic, projektuar në funksion të shërbimeve që do të kryhen.

Skema statike e llogaritjes se struktures parashikon te gjitha nyjet e inkastruara. Eshte zgjedhur nje rrjet kollonash ne menyre te tille qe te plotesojne kerkesat arkitektonike dhe te shmange perdredhjen e struktures ne boshtin vertikal.

Struktura do te jete monolite prej betoni te armuar dhe do te jete beton M-250 dhe hekur Feb-44k. Themelet jane percaktuar te zhytur me themele te vazhduar me gjeresi 60 cm, nen te cilen do te shtrohet nje shtrese zhavori me H=40cm.

Llogaritja eshte bese sipas kushteve teknike shqiptare te projektimit, persa i perket percaktimit te ngarkesave e forcave te brendshme ne strukture. Ndersa, percaktimi i armatures eshte sipas EC-2 dhe EC-8 (pasi eshte llogaritur ne STEREO-STATICA program i cili ne algortimin e tij perdor eurocodet.)



Përgatitja e formacioneve përfshin këto punë:

- Njohja dhe saktësimi i rrjeteve të instalimeve nën tokë si p.sh.: tuba të furnizimit të ujësjellësit, tuba të shkarkimit, kablllo elektrike e telefonie etj.
- Matja e terrenit dhe marrja e provave të dheut
- Hapja e gropave të themeleve deri në thellësinë e nevojshme

Te gjitha punimet si germimet për hapjen e themeleve, betonimet të behen me kujdes duke respektuar masat e sigurimit teknik në punë, në baze të një plan organizimi të miratuar, nga punonjes të kualifikuar me punime të tilla dhe në drejtimin direkt të drejtuesit teknik dhe supervisorit të punimeve. Përpara çdo procesi të kontrollohen dimensionet e dhena në projekt me ato faktike dhe për çdo pasaktesi të njoftohet projektuesi.

Germime

Gërmim dheu për themele ose për punime nëntokësore, deri në thellësinë 1,5 m nga rrafshi i tokës, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të thatë ose të lagur (argjilë edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gurë etj.) duke përfshirë prerjen dhe heqjen e rrënjëve, trungjeve, gurëve, dhe pjesëve me volum deri në 0.30 m³, plotësimin e e detyrimeve në lidhje me ndërtimet e nëndheshme si kanalet e ujrave të zeza, tubacionet në përgjithësi etj..

Punime Tarrace

Punimi i sipërfaqeve vertikale i përgatitur për instalimin e membranave izoluese. Shtresa izoluese duhet shtrirë në një sipërfaqe të thatë, të pastruar e niveluar mirë më parë me shtresë horizontale pjerrësi si dhe sipërfaqet vertikale. Këto trajtohen fillimisht me një shtresë bituminoze, dhe mbi këto fillon vendosja e fletëve bituminoze, me fibër minerale, secila me trashësi 3 mm, të ngjitura me ngrohje dhe në mënyrë të tillë, që fletët t'i mbivendosen njëra-tjetrës, në sipërfaqe të pjerrëta ose vertikale, duke u siguruar që mbulesa e elementëve të bashkuara të jetë minimumi 10 cm.

Termoizolimi


Termoizolimi realizohet duke përdorur materiale termoizoluese (penobeton ose polisterol) të vendosura në formë të pjerrët në zonat e shtresave hidroizoluese. Mbulimi me shtresa llaçi i pjerrësisë së kërkuar me një minimum trashësie prej 3 cm, e realizuar me llaç çimento (tipi 1:2), e niveluar për instalimin e shtresës izoluese.

Hidroizolimi duhet shtrirë në një sipërfaqe të thatë, të niveluar më parë, duke përfshirë sipërfaqe vertikale, të trajtuar me shtresë të parë bituminoze si veshje e parë. Mbi këtë vendosen dy fletë bituminoze, me fibër minerale, secila me trashësi min. 3 mm, e ngjitur me flakë, me membrana të vendosura në këndet e dhura mbi njëra-tjetrën, në sipërfaqe të pjerrëta ose vertikale, duke u siguruar se mbulesa e elementeve të bashkuara të jetë 12 cm.

Ulluqet horizontale

Realizohen me pjerrësi prej 1% për largimin e ujrave. Ulluqet horizontale prodhohen me llamarinë prej celiku të xinguar me trashësi jo më të vogël se 0,8 mm.

Ulluqet vertikale



Ulluqet vertikale për shkarkimin e ujrave të tarracave që përgatiten me llamarinë prej çeliku të xinguar, duhet të kenë trashësi jo më të vogël se 0.6 mm dhe diametër 10 cmm. Në çdo ulluk duhet të mbliidhen ujrata e një sipërfaqe tarrace jo më të madhe se 60 m².

Punime themeli

Betoni do të jetë një përzierje e çimentos Portland, ujit dhe agregateve me ose pa boshllëqe ajri apo shtesa për pakësimin e përmbajtje së ujit.

E gjithë çimentoja e përdorur do të jetë, veçse po të thuhet ndryshe, çimento e zakonshme Portland e cilësisë më të mirë të një marke të aprovuar nga Inxhinieri dhe do të plotësojë në çdo drejtim me B.S. No. 12 për çimenton Portland dhe me ASTM C150, Tipi 1.

I gjithë ndërtimi prej betoni poshtë pllakave në kontakt me tokën duhet të jetë prej çimentoje Portland me rezistencë sulfate dhe duhet të jetë e hidroizoluar dhe në përputhje me Standartin Britanik, BS. 4027, Part 2: 1972 ose ASTM- C150, Tipi V.

Çdo thes çimento duhet të ketë të stampuar emrin e prodhuesit dhe numrin e serisë. Lloji i çimentos duhet të jetë i njëjtë me atë të përmendur në raportin e analizës. Nuk duhet të përdoren thasë të përdorur njëherë me pare.

Çimentoja duhet të shpërndarjes në terren në thasë të vulosur në sasi të mjaftueshme për të siguruar që të mos ketë pezullim apo ndërprerje të punës së betonimit në çdo kohë.

Nuk duhet të përdoret as çimentoja e ndenjtur dhe as e ngurtësuar. Çimentoja e mbetur në sasi të mëdha në fabrikë për më tepër se tre muaj pa u shpërndarë, ose çimentoja në thasë të ruajtur me magazina lokale nga Kontraktori apo nga një shitës për më tepër se një muaj pas shpërndarjes nga fabrika, mund të testohet përpara përdorimit dhe duhet të kthehet mbrapsht nëse rezulton se nuk përmbush ndonjë nga kërkesat e këtyre Specifikimeve.

Agregatet

Agregatet e përdorur në punimet e përherëshme duhet të jenë materiale natyrale të marra vetëm nga burime të aprovuara.

Përpara se çdo material nga ndonjë burim i veçantë të përdoret, Kontraktori duhet të marrë kampione të çdo madhësie që ai propozon për përdorim dhe duhet të kryejë të gjitha provat dhe analizat e nevojshme për të treguar se kampionet përputhen me Specifikimet.

Rezultatet e këtyre provave, etj. Duhet të paraqiten tek Përfaqësuesi i Inxhinierit dhe aprovimi i tij duhet të merret para se materiali të përdoret në punime. Pjesë e çdo kampioni do të nevojitet për kryerjen e provave të përzierjes së betonit dhe një pjesë duhet të mbahet për t'u krahasuar me shpërndarjet e mëpasme.

Agregati i imët duhet të jetë natyral ose rërë e prodhuar dhe modulet e imtësisë nuk duhet të variojnë më shumë se +0.20 nga vlera e përdorur në përcaktimin e raporteve të përzierjes. Nëse do të përdoret rërë natyrale ajo duhet të merret nga një karrierë e parovuar nga Inxhinieri.

Agregati i ashpër (kokërr madh) duhet të jetë agregat i marrë nga karrierat e aprovuara nga Inxhinieri.



Hekuri

Ky punim do të konsistojë në furnizimin dhe vendosjen e hekurit për armim sipas Specifikimeve dhe në përputhje me vizatimet.

Hekuri për armim duhet të jetë shufra me rezistencë të lartë në tërheqje dhe në përkulje dhe të plotësojë kërkesat e ASTM A615 dhe me një rezistencë të garantuar në këputje jo më pak se 42 N/mm².

Hekuri i butë me rezistencë të ulët duhet të garantojë një rezistencë në këputje jo më pak se 250 N/mm².

Teli që përdoret për lidhjen e hekurit punues do të jete nga hekuri i butë i zi i rrumbullakët. Diametri i këtij teli nuk duhet të jetë më pak se 16 S.W.G. (1.6 mm) dhe lidhja duhet të përdridhet fort me pinca speciale. Fundet e lira të telit lidhës duhet të kthehen nga ana e brendshme.

Punime strukture metalike

Mbledhja e ujrave behet fillimisht nga ulluqet vertikale prej llamarine çeliku të xinguar e me pas nga ulluqet vertikale. Ulluqet vertikale për shkarkimin e ujrave të tarracave që përgatiten me llamarinë prej çeliku të xinguar, duhet të kenë trashësi jo më të vogël se 0.6 mm dhe diametër 10 cm.

Veshja e struktures metalike.

Veshja e struktures metalike behet po me panel sandwich, duke patur nje ambient sa me konfort. Shtresat jane te realizuara me dysHEME industriale

Dyer dritare


Furnizimi dhe vendosja e dritareve, siç përshkruhet në specifikimet teknike me dimensione të dhëna nga kontraktori, përbëhen nga material alumini, profilet e të cilit janë sipas standarteve Europiane EN 573-3 dhe janë profile të lyera përpara se të vendosen në objekt. Ngjyra e dritares do të jetë sipas kërkesës së investitorit.

Korniza fikse e dritare do të ketë një dimension 61-90 mm. Ato janë të siguruar me elemente që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit, si dhe me pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të dritares. Forma e profilit është tubolare me qëllim që të mbledhë gjithë aksesorët e saj. Profili i kanates të dritares do të jetë me dimensione të tilla 25 mm që do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur.

Profilet e kornizave të lëvizshme kanë një dimension: gjerësia 32 mm dhe lartësia 75 mm të sheshta ose me zgjedhje ornamentale.

Profilet e aluminit do të jenë të lyera sipas procesit të pjekjes lacquering.

Temperatura e pjekjes nuk duhet të kalojë 180 gradë, dhe koha e pjekjes do të jetë më pak se 15 minuta. Trashësia e lacquering duhet të jetë së paku 45 mm. Pudrosja e përdorur do të bëhet me resins acrylic të cilësisë së lartë ose me polyesters linear. Spesori i duraluminit duhet të jetë minimumi 1,5 mm.



Panelet e xhamit (4 mm të trasha kur xhami është transparent dhe 6 mm të trasha kur janë të përforcuara me rrjet teli ose me dopio xham). Ato do të jenë të fiksuara në skeletin metalik me anë të listelave të aluminit në profilet metalike të dritare dhe të shoqëruara me gomina. Të gjitha punët e lidhura me muraturën dhe të gjitha kërkesat e tjera për kompletimin e punës duhet të bëhen me kujdes. Një model i materialeve të propozuara do të shqyrtohet nga supervizori për një aprovim paraprak.

f) *informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;*

- Furnizimi me uje

Për sistemin e furnizimit me ujë të ndërtesës do te behet nga rrjeti aktual i zones se fshatit Qukes Shkumbin. Njesia Administrative Qukes dhe Ndermarrja qe administron rrjetin do te japin piken e lidhjes. Per ndertimin e rrjetit te brendshme mund të përdoren tuba plastike PPR (Polipropilen) që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 9001 dhe DIN 8078 (kërkesat për cilësinë dhe testimin e tubave) ose mund të përdoren tuba xingato që janë konform standarteve të mësipërm për cilësinë dhe testimin e tyre. Theksojmë se tubat prej PPR janë afro 15 herë më të lehtë se tubat e çelikut.

Tubat për furnizimin me ujë duhet të sigurojnë rezistencë ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjentëve kimikë, peshë të lehtë, mudnësi të thjeshta riparimi e transporti, ngjitje të thjeshtë dhe të shpejtë, jetëgjatësi mbi 30 vjet dhe rezistencë ndaj ujit të ngrohtë.

- Rrjeti i jashtem i shkarkimeve

Ne sheshin e ndertimit nuk kalon sistemi i KUZ (Kanalizimeve te Ujrave te Zeza). Projekti i propozuar ka parashikuar ndertimin e nje Grope Septike me kapacitet 81 m3, Gropa septik ka forme drejte kendore dhe permasa 9 m gjatesi, 3 m gjeresi dhe 3 m thelesi dhe eshte ndertuar ne anen jugore te sheshit te ndertimit ne pjesen e pasme te fabrikes.


Për shkarkimet e ujrave do të përdoren tuba plastike PVC që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 4427 dhe prEN 12201.

Këto tuba duhet të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjentëve kimike, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe lidhje, ngjitje të thjeshtë dhe të shpejtë.

Përmasat e tubave do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të ndotur, shpejtësisë së lëvizjes dhe shkallës së mbushjes së tyre. Gjatë llogaritjeve, shpejtësia e lëvizjes duhet të merret 1-2 m/sek, kurse shkalla e mbushjes duhet të jetë 0,5 – 0,8 e seksionit të tubit.

Tubat e shkarkimit duhet të vendosen në të gjithë lartësinë e ndërtesës, në formën e kollonave, në ato nyje sanitare ku aparatet janë më të grupuara dhe mundësisht sa më afës atyre nyjeve që mbledhin më shumë ujëra të ndotura dhe ndotje më të mëdha.

- Instalimet elektrike



Lidhja me infrastrukturen e furnizimit me energji elektrike. Ne zone ku do te zhvillohet projekti eshte i shtri re rrjeti i furnizimit me energji elektrike 6kV. Të gjitha kablloset duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të kenë në anë etiketën dhe vulën e prodhuesit ose prova të tjera të origjinës dhe kontraktuesi duhet të marrë çertifikatat e testeve të përhershme të prodhuesit kundrejt një urdhri të dhënë, n.q.s. kërkohet nga Inxhinieri.

Numri i kabllove që duhen instaluar në tuba duhet të jetë aq sa të lejojë futjen e lehtë pa dëme të kabllove dhe nuk duhet të zërë në asnjë rrethanë më shumë se 40% të hapësirës. Instalimi duhet të përputhet me KTZ në Shqipëri.

Asnjë kabëll me seksion më të vogël se 2.5 mm² s' duhet të përdoret me instalim vetëm nëse përmendet në veçanti. Përçuesit e tokës duhet të kenë një masë minimale të kërkuar nga rregullorja.

Objekti eshte i lidhur me rrugen ekzistuese dhe me rrugen kombetare Librazhd Pogradec dhe, nuk ka nevojë për ndertimin e nje rruge te re.

- g) *programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit.*

Sipas projektit të hartuar, periudha e ndërtimit do të zgjase 8 muaj.

Kohëzgjatja e funksionimit është menduar 25-30 vjet. Faza e rehabilitimit nuk është parashikuar pasi nuk është e nevojshme sepse objekti është kapaon dhe mund të shfrytëzohet për të zhvilluar një aktivitet tjetër në të ardhmen.

- h) *lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);*

Materialet dhe karakteristikat e tyre:

Referuar projektit të propozuar, materialet do të jënë:

a) Beton	C20/25
b) Çelik	Ç3
c) Panel Sanduiç	60 mm
d) Çelik	Feb-44K
e) Stafa	Feb-44K

- Betonet $R_{k}=300$ për pllaken b/a të themelit, kolona mure b/a të mbistruktues dhe të bodrumit, traret dhe soletat, shkallat
 - Çeliku që do të përdoret të jetë i tipit FeB44K ose Sidenor S500 S
 - Materiali mbushës i soletave 30 cm të jetë tulle solete me lartësi 25 cm e lehtësur ose me dëshirë të investitorit polisteron, në rastin e përdorimit të polisteronit para vendosjes së tij të vendoset një rrjetë teli 2x2 cm për suvatim.
 - Tulla e përdorur të jetë e tipit të lehtësuar 10 cm për muret e brendshme. Në muraturën e tullës të realizohen breza lidhës në kuotat e arkiturave të dyrve dhe dritareve si dhe për muret e jashtme përveç tij edhe nën kuotën e dritareve. Muratura të realizohet me llac bastard M30
- i) *informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit*



Projekti nuk lidhet me projekte te tjera ekzistuese ne kete zone. Do te shfrytezohet aksesesi nga rruga dytesore qe lidhet me rrugen e kombetare Qukes - Librazhd

j) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret

Nuk jane marre ne konsiderate, alterantiva te tjera ne lidhje me vendosjen e objektit pasi zgjedhja ka qene e kushtezuar nga pronesia mbi token. Ne lidhje me pozicionimin bernda sheshit te ndertimit jane marre ne konsiderate kerkesat qe ka VKM ne lidhje me vendosjen e objekte me natyre bujqesore dhe per te shmangur sa me shume zenien e panevojshme te tokes.

k) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasinë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre

Gjate funksionimit do te perdoren:

- Lenda e Pare, Qumesht i grumbulluar nga prodhuesit lokal dhe fermeret e zones. Eshte parashikuar q ete perpunohet mesatarisht 2000 litra ne dite qumesht ndonse linja ka kapacitet perpunues me te madh.
- Energji elektrike, me nje konsum mujor mestarishyt 5000 kWh
- Uje, kryesisht per proceset higjeno-sanitare ne fabrike, minimalisht 1000 litra ne dite.

l) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj

Per zbatimin e projektit nuk nevojiten aktivitete te tjera.

m) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit

Mbeshtetur ne Ligjin Nr,107/2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit", si dhe ne VKM Nr. 408, date 13.05.2015 "Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit", sipas nenit 9, projekti per ndertimin e Magazines per ruajtjen e produkteve bujqesore, duhet te pajiset me Leje Zhvillimi qe leshohet nga Autoriteti i Njesise se Qeverisjes Vendore qe ne kete rast eshte Bashkia Prrenjjas.

Pregatiti

Shoqeria "CURRI" Sh.p.k.


Licence N.0005/10

Inxh. Faik CURRI



PLANIMETRIA E FABRIKES SE PERPUNIMIT TE QUMESHITIT ME INVESTITOR Z. ENGJELLUSH ALLIU

ZONIMI FUNKSIONAL



- 1 Grumbullimi i qumeshitit nga autoboti
- 2 Pasterizimi dhe homogjenizimi
- 3 Konservimi i qumeshitit pas pasterizimit
- 4 Prodhimi i Djathit
 - a - Presa
 - b - Makineria e perzierjes
 - c - Vaska e djathit
 - d - Ndarja
 - e - Shellira dhe prerja
 - f - Ajrimi
 - g - Maturimi dhe paketimi
- 5 Prodhimi i Kosit
 - a - Ftoja
 - b - Aromatizues
 - c - Homogjenizues
- 6 Prodhimi i Salces
- 7 Prodhimi i Gjizes
- 8 Prodhimi i Qumeshitit UHT
- 9 Prodhimi i qumeshitit UHT
- 10 Prodhimi i Dhalles
- 11 Dhome Frigoriferike
- 12 Trajtimi i Paketimeve
 - a - Seleksionimi
 - b - Trajtimi i sterilizimit
 - c - Shperndarja
- 13 Magazinimi i paketimeve te seleksionuara
- 14 Kodifikimi Etiketim
- 15 Magazinimi
- 16 Shperndarja e produkteve
- 17 Zona e veshjes se punonjese
- 18 Zona e larjes se duarve
- 19 Zona e Desinfektimit te Cizmeve
- 20 Shperndarja e produkteve
- 21 Zona e veshjes se punonjese
- 22 Zona e larjes se duarve
- 23 Zona e Desinfektimit te Cizmeve
- 24 Financa
- 25 Kontrolli i Cilesise
- 26 Laboratori i Pergjithshem
- 27 Zyra e Drejtorit
- 28 Financa

OBJEKTI: FABRIKE E PERPUNIMIT TE QUMESHITIT

INVESTITORI: ENGJELLUSH ALLIU

VENDNDODHJA: Oshkës-LIBRAZHD

PROJEKTI: Fabrike e Qumeshitit, Shkurtor 2011

EMERTIMI I FLETES: PLANIMETRIA SH.1:150

DATE: Qershor 2016

FAJETA Nr. A-04

SHKURTERI - ALBANIA

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTEVE DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Liçencave Profesionale për Punët Publike

L I Ç E N C E
N.0005/10

SHOQERIA: " C U R R I "

DREJTUES LIGJOR FAIK CURRI
DREJTUES TEKNIK FAIK CURRI, KRISTO KANA,
DAVID FRANJA, GJON KOLNIKAJ

ADRESA: SHKODER

Regjistruar ne Regjistrin
themeltar qe nga data: 28.08.2007

NE ZBATIM

Kat.	1		Germime dhe me punime eventuale murature e beton arme – prishje dhe punime ne toke te germuar.
Kat.	2	a	Prodhim materiale inerte - gure .
		c	Prodhim elemente betoni e betonarme te zakonshme – paranderur – gure dekorativ.
Kat.	3		a , b , c Ndertime civile dhe ekonomike
Kat.	4	a	Nderim rruge kategoria IV dhe V.
		b	Nderime rruge kat.III, dhe II - I
		c	Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge ,nderim mbishtrusa rrugore.
		d	Nderim autostrade.
Kat.	5	a	Punime hekurudhore.
		c	Punime ne sistemin elektrik dhe te sinjalizimit.
Kat.	6		a , b , c Nderim ura dhe vepra arti.
Kat.	7	a	Nderime portuale – bankina – basena – pontile.
Kat.	8	a	Nderim ujsjelles – kanalizime – kanale e impiante vaditje.
		b	Punime mbrojte te sistemit hidraulik – cimentime etj.
		c	Nderim impianti te trajtimit te ujit
		d	Nderim vajsjelles – gazsjelles – naftesjelles.
		e	Nderim diga – damba deri 10 m.
		f	Nderim galeri tunele.
Kat.	9	a	Sillosa, kulla, kulla uji etj prej b/arme - metalike.
		b	Perforcim themeli e punime nen tokesore.
		c	Izolime mbi dhe nen tokesore nga ujrat
		d	Themele te vecanta.
Kat.	10	a	Restaurim I ndertesave monument kulture.
Kat.	11		a , b Punime karpentjerie
Kat.	12		a , b , c , d , e , f , g Impiante teknologjike dhe te vecanta
Kat.	13		a , b , c , d , e Punime montimi ne impiantet e prodhimit dhe te shperndarjes se energjise.
Kat.	14	a	Ndricimi dhe sinjalizimi urban.
Kat.	15	a	Rivelime topografike.
		b	Punime topogjeodezike ne objekte inxhinierike.
		c	Punime speciale gjeodezike ,rrjeta mbeshketese ,qendrushmeri terenesh.
Kat.	16	a	Sinjalizimi ne rruge auto ketegoria V, IV, III, II.
		b	Sinjalizimi ne rruge auto ketegoria I, autostrada dhe degezime me hekurudhen.

NE PROJEKTIM

Kat.	3	a	Objekte civile – Industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate.
Kat.	4	a	Instalime hidrosanitare.
		b	Instalim termoteknik – ventilim – kondicionim.
		c	Linja errjeta elektrike –telefonike–radiotelefoni–citofoni–sistemalarmi- televiziv etj per objekte civile ,industriale , turistike.
Kat.	5	b	Furnizim me uje - kolektore shkarkimi
		c	Projektim ujsjelles kanalizime urbane – rurale.
		g	Vepra naftesjelles –gazsjelles –vajsjelles.
Kat.	6	a	Rruge auto kategoria V dhe IV.
		c	Projektim shtresa rrugore e sistemit – asfaltim.
Kat.	7	a	Projektim ura dhe vepra arti deri 10 m.
Kat.	8	a	Bazamente gjeodezike per rivelime ne te gjitha shkallet
Kat.	10		a , b , c , d , e Projektim impiante te prodhimit dhe shperndarje te energjise

KRYETARI I KOMISIONIT

Stavri Ristani
Stavri RISTANI

Shenim: Kjo licence eshte e vlefshme deri me daten 09.12.2008.

